



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L -144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20 të Rregullores së QRK-së, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM NPK “TRAFIKU URBAN”

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim NPK “Trafiku Urban”, SHA, në Prishtinë.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: sipërfaqen prej 37239 m², në pjesën e parcelës kadastrale nr. 2892-3, Zona kadastrale Prishtinë, PSH, Kuvendi Komunal Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është dhënia në shfrytëzimin e hapësirës.
- IV.** Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është afatshkurtër, në periudhën kohore për 5 (pesë) vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.
- V.** Prona e paluajtshme e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.

IX. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- kërkesa,
- skica grafike,
- certifikata e njësisë kadastrale dhe
- destinimi për parcelën kadastrale, nr. 2892-3, Zona kadastrale Prishtinë.

X. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0049033/19, më 01.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta